

**VERA VELANOVSKA**



# **ARSIMI TEKNIK**

**PËR KLASËN IV  
TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR**

Vera Velanovska

**Arsimi teknik**

Për klasën IV

të arsimit fillor nëntëvjeçar

Komisioni recenzues për vlerësim profesional të dorëshkrimit i formuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, në përbërje prej:

prof. Petko Shajnovski-kryetar

prof. Vangelica Popovska-anëtare

prof. Vangelina Mojanoska-anëtare

Redaktor teknik Gabriella Misovska

Redaktor grafik Marija Velanovska

Lektor i botimit në maqedonisht Daniella Nikoliq

Përpunimi kompjuterik Dungevski Zlatko

Përkthyes Sadulla Kamberi

Redaktim profesional prof. dr. Aslan Hamiti

Lektor i botimit në shqip mr. Ismail Hamiti

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtyp: Qendra grafike shpkp, Shkup

Tirazhi: 6.700

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr.10-1631/1 të datës 19.06.2009, lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека

“Св.Климент Охридски”, Скопје

ВЕЉАНОВСКА, Вера

Техничко образование за IV одделение во деветгодишно образование / Вера

Вељановска. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република

Македонија, 2009. - 53 стр. : илустр. ; 29 см

ISBN 978-608-4575-01-6

373.3.016:62(075.2)=163.3

COBISS.MK-ID 79206154

## Hyrje

*Këtë vit shkollor për herë të parë do të njihesh me lëndën mësimore Arsimi teknik.*

*Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është që nxënësit të arrijnë dituri dhe shkathtësi në fushat tekniko-teknologjike bashkëkohore.*

*Përmbajtjet e shtjelluara në këtë libër janë të parapara me planin mësimor të shkollimit nëntëvjeçar.*

*Nxënësit aftësohen për aplikimin e tyre në mësim, në jetën e përditshme dhe në punë, dhe pastaj e nxisin dhe zhvillojnë interesin dhe aftësitë për krijimtari teknike dhe novacion.*

*Dituritë dhe shkathtësitë e fituara nga fushat e ndryshme të caktuara teknike, i zhvillojnë operacionet e të menduarit dhe të punës dhe të mundësojnë që të bëhesh konstruktor, teknik, inxhinier ose novator në fushën e teknikës.*

*Detyrat e punës do të mundësojnë që të fitosh dituri elementare, shkathtësi dhe shprehi për manipulim të drejtë me veglat dhe mjetet për punimin me dorë të materialeve: letër, karton, tekstil dhe dru.*

## Lexo me kujdes.

*Të mësuarit e ligjshmërive, rregullave dhe procedurave do të ndihmojnë që t'i njohësh fshehtësitë e teknikës. Njohuritë elementare nga të shkruarit grafik, krijimtarisë teknike, komunikacionit do të mundësojnë që të këmbesh ide dhe të komunikosh me shokët nga e gjithë bota.*

*Përmbajtjet nga kjo lëndë mësimore do të realizohen përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë, procedurave hulumtuese, aktivitetet dhe ndërtimet e modeleve dhe maketeve.*

*Në tema do të hasësh në shumë këshilla të rëndësishme dhe të njëjtat do t'i përdorësh në arsimimin tënd, gjatë jetës tënde dhe punës së mëtejshme.*

**STUDIO, VËZHGO, SQARO, HULUMTO, NDËRTO,  
KONSTRUKTO DHE ARGËTOHU**

***Autori***

# PËRMBAJTJA



## TË SHKRUARIT GRAFIK

➔ 6

- ➔ Organizimi i vendit të punës ➔ 7
- ➔ Llojet e vijave ➔ 8
- ➔ Nga ideja deri te realizimi (skica dhe vizatimi teknik) ➔ 12
- ➔ Njohja me matjen ➔ 14
- ➔ Përpjesëtimi ➔ 16
- ➔ Kuotimi ➔ 17
- ➔ Vizatimi i skicës dhe figurave të thjeshta në kompjuter në Paint ➔ 18



## MATERIALET, NDËRTIMI DHE FORMA

➔ 20

- ➔ Fitimi i letrës dhe i gjysmë kartonit (llojet dhe vetitë) ➔ 21
- ➔ Riciklimi i letrës së vjetër ➔ 25
- ➔ Procedurat e punës gjatë përpunimit të letrës dhe gjysmë kartonit ➔ 26
- ➔ Përpunimi i origamive ➔ 28
- ➔ Të fituarit e tekstilit (gjysmë-prodhimet natyrore dhe artificiale, teknologjia, llojet dhe vetitë) ➔ 30
- ➔ Njohja me gjysmë-prodhimet e drurit ➔ 32
- ➔ Mbrojtja e drurit ➔ 37
- ➔ Procedurat e punës gjatë përpunimit të drurit ➔ 38



### **KRIJIMTARIA KONSTRUKTIVE**

**➔ 40**

- ➔ Elementet për mbërthim (vidha dhe kundërvridha) **➔ 41**
- ➔ Mbërthimi dhe çmontimi i modeleve dhe maketeve nga elementet e gatshme **➔ 42**
- ➔ Aplikimi praktik i origjinalëve **➔ 44**



### **KOMUNIKACIONI**

**➔ 46**

- ➔ Rregulla dhe dispozita për lëvizjen e këmbësorëve në komunikacion **➔ 48**
- ➔ Rregullimi i udhëkryqit me shenja të komunikacionit dhe sinjalizimi me drita i komunikacionit **➔ 49**
- ➔ Vizatimi i shenjave të komunikacionit në *Paint* **➔ 51**



### **NOCIONE TË PANJOHURA - FJALOR**

**➔ 52**



## NJOHJA E SHENJAVE GRAFIKE

Në jetën e përditshme njeriu ballafaqohet me shenja dhe simbole të ndryshme grafike. Krahas fjalës së shkruar dhe të folur, për marrëveshje të ndërsjellë ai përdor më shumë shenja dhe simbole të standardizuara grafike në të gjitha fushat e shkencës, teknikës dhe të teknologjisë.

Nevojat e njeriut bashkëkohor në punën dhe jetën e përditshme, kërkojnë nga ai njohuri elementare tekniko-teknologjike.



## ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

Shumë më herët, para se të mësojnë të lexojnë, njerëzit kanë komunikuar me simbole grafike dhe janë shprehur në mënyrë grafike.

Këmbimi i ideve, i lajmërimeve, të kuptuarit, dërgimi dhe pranimi i porosive me ndihmën e vizatimit teknik, skicës punuese dhe simbolit grafik quhet **KOMUNIKIM GRAFIK**

Pasqyrimi grafik i dukurive, proceseve dhe sendeve, ideve dhe mendimeve është mjaft i rëndësishëm për komunikimin e njerëzve nga shkenca, teknika dhe kultura. Nëse e zotëron shkrimin grafik, shumë lehtë është që të prezantoni në mënyrë grafike sende, mendime, ide dhe të ngjashme.

## VËZHGO DHE SQARO



- Zgjedh një nga simbolet.
- Përshkruaj se ku e ke vërejtur!



Simbolet grafike



## HULUMTO DHE KUPTO

- Në çka të paralajmëron shenja e komunikacionit ?
- Lexoje shenjën e komunikacionit.



Shenja e komunikacionit



## ORGANIZIMI I VENDIT TË PUNËS

Përmbajtja mësimore Arsimi teknik më shpesh zhvillohet në kabinetin e shkollës. Hapësira shkollore më shpesh është e pajisur me tavolinë pune dhe karrige, dollap për vegla, tabelë dhe mjete mësimore. Këtu bëjnë pjesë materialet e nevojshme për punë. Për shkak të sigurisë në punë duhet të kemi kujdes kur manipulohet me veglat e punës, ndërsa ora të organizohet më mirë. Nxënësit, arsimtarët dhe të tjerët që janë prezent në punë duhet t'i respektojnë rregullat për siguri elementare, dhe me këtë ora dhe mësimi praktik do të jenë të suksesshëm. Detyrë e çdo nxënësi është që t'i respektoj rregullat, rendin dhe disiplinën në kabinetin mësimor. Vendi i punës çdo herë duhet të jetë i rregulluar dhe i pastër.



### Ç'është vendi i punës?

*Vendi i punës është hapësirë ku realizohen detyrat e punës, respektivisht hapësira ku kryhet ndonjë punë.*

### VËZHGO DHE SQARO



Në vendin e punës veglat rrinë nga ana e djathtë, materiali nga ana e majtë. Vizatimin teknik dhe pajisjen për vizatim vendosi në mes të tavolinës. Pajisja, veglat dhe materiali duhet çdoherë të jenë të kapshëm për të dy duart, që të mund t'i arrish pa u munduar fare. Respektoi rregullat për punë dhe në mënyrë të suksesshme do t'i realizosh detyrat e punës.



## HULUMTO DHE KUPTO




- Ç'është karakteristike për vendet e punës nga veprimtari të ndryshme të cilat janë dhënë në fotografitë?



## LLOJET E VIJAVE

Mjeti elementar për komunikim në teknikë është vizatimi teknik. Me të përcillen idetë dhe porositë e objekteve të përfytyruara, sende, modele dhe maket që duhet të bëhen dhe të përdoren. Vizatimi teknik është dokument i vizatuar në fletë letre në të cilin tregohet ndonjë zgjidhje teknike. Personi i cili i vizaton këto vizatime quhet vizatues teknik. Vizatimi teknik ka për qëllim në mënyrë të qartë ta përcjellë specifikimin e objektit të krijuar.



## PAJISJE PËR VIZATIM TEKNIK

### VËZHGO DHE SQARO



- Kur, ku, dhe pse i përdorim veglat për vizatim teknik?



Kur bën ndonjë vizatim teknik duhet të dish të manipulosh me pajisjet. Me ushtrime të mjaftueshme për përdorim të drejtë dhe vizatim me dy trekëndësha nuk do të paraqesë vështirësi. Zgjedhja e lapsit për përpunim të vizatimit teknik bëje sipas shenjës (simbolit) i cili është shkruar në laps:

- Lapsin e fortë njihet sipas shenjës (simbolit) „H” (ha), ndërsa lapsi i butë është shënuar me „B” (be). Ato janë simbole. Përkaj simboleve të lapsit janë shënuar edhe numra. Numrat e tregojnë shkallën e fortësisë së lapsit. Nëse numri është më i madh, lapsi është më i fortë, dhe e kundërta.
- Vizorja, dy trekëndësha, kompasi, mprehësja dhe goma për fshirje janë vegla plotësuese për vizatim teknik.
- Rregullshmëria e veglave për vizatim teknik ndikon në kualitetin e përpunimit të vizatimit teknik.




## Llojet e vijave teknike


Pamja	Përshkrimi	Përdorimi
	E plotë – vijë e trashë	Për vizatim të teheve të dukshme të objektit
	E plotë – vijë e hollë	Për kuotimin e objektit
	Vijë e ndërprerë	Për tehet e padukshme të objektit
	Vizë - pikë - vizë	Vija e mesit
	Vijë e lirë	Për ndërprerje dhe prerje



## VËZHGO DHE SQARO





Ç'është karakteristike për rëndësinë e vijave teknike tek figurat dhe trupat gjeometrikë?




Trekëndëshi




Drejkëndëshi



Koni



Cilindri



Kuadrati



## MËSO SI PËRDOREN VEGLAT PËR VIZATIM TEKNIK

Kur tërheq vija gjatë punimit të vizatimit teknik, lapsi duhet që të mbështetet në anën e trekëndëshit. Nëse dëshiron që vija të jetë e hollë, mbaje lapsin drejt (vertikalisht) dhe mos e shtyp. Kur tërheq vijë plotë – vijë të trashë, lapsin anojë në kah të tërheqjes së vijës.



Pajisje për punim të vizatimit teknik



## ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Vërej dhe përfundo nga fotografia cili trekëndësh është prej  $30^\circ$  shkallëve, dhe cili prej  $45^\circ$  shkallëve?
- Trekëndëshat çdoherë duhet të jenë të pastër. Nëse nuk janë të pastër çka ndodh?



## HULUMTO DHE KUPTO

- Mundohu që të vizatosh vija paralele, dhe gjatë kësaj të përdorësh dy trekëndësha.

## VËZHGO DHE SQARO




- Mendo si duhet t'i vendosësh trekëndëshat prej  $30$  dhe  $45$  shkallëve që të mundemi më lehtë të tërheqim vija horizontale, vertikale, të pjerrëta dhe paralele.


## VËZHGO DHE SQARO



- Në vizatim është treguar tërheqja teknike e vijave të pjerrëta paralele me dy trekëndësha.
- Mundohu që të vizatosh me ndihmën e dy trekëndëshave, vija horizontale dhe vertikale paralele.
- Kur tërheq vija, maja e lapsit duhet të mbështetet në anën nga trekëndëshi.
- Lapsin përkule në kah të tërheqjes së vijës.



Tërheqja e vijave me dy trekëndësha




- Mundohu, në fletoren e punës, që të tërheqësh vija paralele me veglat për vizatim. **Mëso dhe argëtohu.**




## NGA IDEJA DERI TE REALIZIMI

Ideja është përfytyrimi elementar për zgjidhjen e mundshme të problemit. Duhet gjithnjë të mendosh dhe të kesh dëshirë t'i realizosh idetë tua. Ajo ndodh si nevojë që të realizohet (krijohet) diçka e re. Mund të kesh më shumë zgjidhje ideore.

Zgjidhjet tua ideore mund t'i paraqesësh me skicë. Skica dhe vizatimi teknik janë dokumentet elementare të punës për komunikim grafik në gjithë botën. Skicimi është aplikim praktik i ideve vetjake. Skica punohet me dorë të lirë.




Skica e tavolinës



Skica e klasës

## VËZHGO DHE SQARO



- Sqaro ç'është pasqyruar në skicat? Diskutoni dhe analizoni.




## HULUMTO DHE KUPTO

### Si më lehtë nga ideja deri te realizimi?



Ajo nuk është vështirë. Mendo, analizo, përgatit fletë të letrës, skico idenë tënde, do të bëhet e vërtetë. Në fotografi janë treguar disa ide, të cilat do të ndihmojnë që ta përpunosh idenë tënde dhe ta realizosh qëllimin.



## VËZHGO DHE SQARO



- Vëzhgo objektet të cilat të rrethojnë. Sigurisht ke ide?
- Mendohu, analizo, skico, përpuno vizatim teknik dhe ndërto.



## NJOFTIMI ME MATJEN

**M**atja është përcaktim i madhësisë reale, që lexohet direkt nga instrumenti matës.

Gjatë kësaj, më shpesh përdoren instrumente matëse (vizore, trekëndësh). Matja është proces me të cilin vërtetohet sa është diçka e gjatë (e matur në milimetra ose centimetra), sa është diçka e rëndë dhe sa është diçka e shpejtë.



### VËSHTRO DHE SQARO



- Për çka shërbejnë instrumentet matëse?
- Kur i përdor instrumentet matëse të paraqitura në fotografi?



Vëzhgoje vizatimin !




Nga përvoja e deritanishme i njeh njësit matëse milimetri (mm), centimetri (cm). Ti je aftësuar që të matësh me këto njësi matëse. Zgjedh objekt, mati madhësitë e tij (gjatësi, gjerësi) me instrument matës sipas zgjedhjes tënde (vizore ose trekëndësh) dhe shëno në fletoren e punës.



## HULUMTO DHE KUPTO


- Lexo dimensionet në fotografitë e dhëna.
- Në vizatimin teknik çdoherë dimensionet i lexojmë në mm.



## VËZHGO DHE SQARO



- Nga instrumenti matës lexoje sa është gjatësia e poçit elektrik?






## PËRPJESTIMI

Sendet të cilat do t'i punosh në punishten e shkollës, sipas vizatimit teknik, janë të vizatuara në madhësitë e tyre reale (natyrore). Ndonjëherë kemi nevojë, sendet që i vizatojmë, t'i zmadhojmë ose zvogëlojmë. Për zgjidhjen e këtyre nevojave në vizatimin teknik aplikohet përpjesëtimi.


### VËZHGO DHE SQARO




M 1:1



M 1:2



M 2:1



**Përpjesëtimi** është relacion i dimensioneve të objektit në madhësi reale (natyrore) dhe dimensionet e objektit që është vizatuar në vizatimin teknik.

Ka tre lloje të përpjesëtimit:

- Madhësi natyrore **1:1** (Lexo një ndaj një)
- Zvogëlim **1:2**
- Zmadhim **2:1**

Përpjesëtimi shënohet me simbol “**R**” ose me simbolin “**M**” dhe lexohet matës.



### Detyrë pune

- Matni dimensionet e pajisjes për lapsa, dhe puno vizatim teknik me përpjesëtim: 1:1; 1:2; 2:1.





## KUOTIMI




**Kuotimi** është vendosje e numrave të kuotës (dimensionet) në vizatimin teknik.

## VËZHGO SHE SQARO



- Çka vëren në vizatimin teknik?



Vizatimi teknik

### Elementet e kuotimit

- Vija e kuotës dhe vija ndihmëse e kuotës vizatohen me vijë të plotë-të hollë.
- Shigjeta e kuotës vizatohet përkaj vijës së kuotës dhe i prekë vijat ndihmëse të kuotës.
- Numri i kuotës shkruhet në mes mbi vijën e kuotës nga e majta në të djathtë.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Çka vëren në vizatim?
- Çka i mungon vizatimit teknik?





## VIZATIMI I FIGURAVE TË THJESHTA NË PROGRAMIN PAINT TË KOMPJUTERIT

Informatika është shkencë për informacionet, për formësimin e tyre, memorizimin, bartjen, përpunimin dhe shfrytëzimin me ndihmën e makinave automatike, kompjuterët. Ajo merret me të studimin e kompjuterëve si mjete bashkëkohore për përpunimin e të dhënave dhe aplikimin e tyre në fusha të ndryshme.



Termi informatikë është fituar me bashkimin e dy rrokjeve të para nga fjala *informata*, dhe tri rrokjet e fundit nga fjalia *automatika*.

Termi *informata* rrjedh nga fjala latine “*informatio*” që do të thotë lajmërim, njohje, kuptim.



*Paint* është aplikacion i thjeshtë grafik. Me ndihmën e këtij aplikacioni mund të krijoni paletë të gjerë vizatimesh dhe fotografish, prej më të thjeshtat, e deri në ato të përkryera. Këtu, përdoren vegla për vizatime me dorë të lirë, vegla për vizatim të vijave dhe figurave gjeometrike (drejtkëndësh, katror dhe rreth), si dhe vegla për: ngjyrosje, pastrim (fshirje), prerje, kopjim, llogaritje nga një pjesë nga fotografia, fut dhe importon tekst. Krahas veglave të lartpërmendura, përdoret edhe paletë e begatshme ngjyrash.

Nisja e aplikacionit grafik *Paint* mund që të realizohet me zgjedhjen e komandave: *Start, All Programs, Accesories, Paint*.

### VËZHGO DHE SQARO



Pjesët përbërëse të dritares elementare *Paint* janë: menyuja standarde, shiriti me vegla (*toolbar*), fusha me veçori për vegla të zgjedhur, paleta me ngjyra, vija statusore dhe sipërfaqja e punës për vizatim, e cila zë pjesën më të madhe të dritares. Identifiko veglat.




Dritarja elementare *Paint*



## HULUMTO DHE KUPTO

- Me cilën vegël mund t'i vizatosh rrahët e treguar në fotografi?
- Mundohu që të vizatosh drejtkëndësh, trekëndësh dhe katror.



### Detyrë shtëpie

- Zgjedh vegël dhe vizato skicë në mësonjëtores e kompjuterit në **Paint**.
- Në bazë të shembullit, puno skicë sipas idesë personale në **Paint**.



Skica e shtëpisë



Skica në vend të punës

- Për realizimin e suksesshëm të detyrës tënde, do të ndihmojnë veglat me të cilat vizaton figura gjeometrike në **Paint**.
- Mundohu dhe vizato skicë të klasës tënde në **Paint**.



## MATERIALET, NDËRTIMI DHE FORMIMI

Çdo punë duhet të planifikohet që më parë. Që të mundet në mënyrë të suksesshme të realizohet puna e planifikuar, duhet të kemi vegla adekuate, mjete dhe material. Përmbaju rendit të punës. Planifikoje kohën për punë.



### Nëse kështu mendon do të mësosh

- Me kohë ta përgatisësh materialin e nevojshëm, pajisjet dhe veglat.
- Vendi i punës të jetë çdoherë i rregulluar dhe i pastër.
- Përmbaju rendit dhe disiplinës në punishten shkollore.
- Kështu do të krijosh kushte për punë të sigurt dhe kualitative.



### ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Me ndarje të drejtë të orarit të punës do të mësosh që të planifikosh.
- Planifikimi veçanërisht do të të ndihmojë në zgjedhjen e detyrave të punës.
- Do t'i njohësh ligjet teknike dhe të tjera.



### HULUMTO DHE KUPTO

- Puna praktike do të mundësojë: që t'i hulumtosh veçoritë e letrës dhe gjysmë kartonit.



Veglat e punës



Maketa



## TË FITUARIT E LETRËS DHE GJYSMËKARTONIT



Letra është material që përdoret në jetën dhe punën e njerëzve.

Fletoret tua dhe librat janë të bëra prej letre. Përdoret për të shkruar, për shtyp, paketim, për përpunimin e ambalazhit etj.



### ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Për prodhimin e letrës përdoren lëndët e para me prejardhja bimore, të cilat në vete përmbajnë materie fibrash – celulozë.
- Lënda e parë bazë për fitimin e letrës është druri, kashta, kërcelli i imtësuar i misrit, barishte të llojllojshme, arna të vjetër, konop dhe letër e vjetër.
- Letra sot prodhohet në fabrika të cilat janë të pajisura me makina speciale. Letra nga makina del në formë të llojit të shiritit të pafund. Mbështillet në masurë ose prehet në tabakë me dimensione të caktuara.



Përpunimi makinerik për fitimin e letrës

- Bëhu iniciator dhe në mënyrë të organizuar me klasën tënde vizito fabrikën për prodhimin e letrës.



Përveç letrës së shkrimit, prodhohen edhe lloje të ndryshme të kartonëve për punimin e kapakëve të librave, ambalazhit, paketimit dhe për nevoja të tjera. Procedura për fitimin e gjysmë kartonit është e njëjtë si te letra.





Prodhimi dhe ambalazhimi i gjysmë kartonit



## ZBULONI PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

### Veçoritë e letrës

- **Fortësia** është rezistenca që e jep letra ndaj veglave gjatë punimit, respektivisht gjatë përthyerjes, thyerjes dhe prerjes.
- **Lidhshmëria** është lidhja e fibrave të letrës që mund t'i vëresh gjatë grisjes dhe thyerjes.
- **Elasticiteti** është rezistenca që e jep letra gjatë lakimit dhe përdredhjes.



Letra me ngjyra

Prerja dhe përdredhja e letrës



### Veçoritë e kartonit

- **Kartoni i hollë** është elastik, nuk pëlçet, nuk thyhet, është i qëndrueshëm dhe lehtë dredhohet. Përdoret për punimin e kapakëve dhe ambalazhit.
- **Kartoni i trashë** është i fortë, nuk është elastik dhe gjatë lakimit thyhet lehtë. Është i përshtatshëm për mbështjellje sepse nuk deformohet lehtë. Përdoret për përpunimin e kopertinave të librave, kutia për ambalazh, dhe për përpunimin e maketeve.
- **Mbështjellja e kartonit**



Mbështjellja



Modele prej kartoni

### VËZHGO DHE SQARO




Modele dhe makete prej letre

- Mëso diçka më tepër për veçoritë e letrës dhe gjysmë kartonit.
- Letra është material që lehtë përpunohet me lakim dhe prerje.
- Pasi t'i kesh përvetësuar këto veçori, mundohu që të punosh sipas idesë tënde model, maket nga letra ose kartoni.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Analizojë fotografinë dhe provoje fortësinë e letrës dhe të letrës ngjitëse të cilën do ta punosh në orën e arsimit teknik.
- Në çka është dallimi?
- Mundohu që të kuptosh kush ka fortësi më të madhe, letra ose letra ngjitëse?
- Me kujdes vëzhgoje fotografinë.
- Bëj letër ngjitëse nga letra.



Letra ngjitëse



Letra me ngjyra


## VËZHGO DHE SQARO



- Në bazë të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet letrës dhe kartonit të mbështjellë, mundohu që të sqarosh ku bëjnë pjesë fotografitë që i vëzhgon.



Punimi prej kartoni të mbështjellë



Përpunime prej letrës





## RICIKLIMI I LETRËS SË VJETËR



### ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Në shkollën tuaj organizo grumbullimin e letrës së vjetër
- Në klasën tuaj, në mënyrë ekipore krijoni koleksion të llojeve të letrës.



Mblidhe / Paketoje letrën e vjetër



Letrën vendose në vendin e shënuar përkatës



Transporti i letrës së vjetër të grumbulluar



Paketimi para riciklimit (ripërtëritja e letrës)



Imtësimi makinerik



Prodhim i gatshëm





## PROCEDURAT E PUNËS GJATË PËRPUNIMIT TË LETRËS DHE TË GJYSMË KARTONIT

Para se të fillosh me punë, shikoje vizatimin dhe lexoje udhëzimin. Modelet dhe maketet nga letra dhe gjysmë kartoni përpunohen dhe ndërtohen nga vizatimi teknik i përgatitur më parë.

Gjatë punimit të modeleve dhe maketeve prej letre dhe gjysmë kartoni, apliko procedurat e punës: *matja dhe shënimi, dredhimi, bashkimi, ngjitja dhe ngjyrosja.*



Procedurat e punes



### ZBULO PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME

***Që detyrat e punës të jenë të suksesshme është e nevojshme që të dish:***

- Shëno dimensionet me mjetet për vizatim teknik në letër dhe gjysmë karton.
- Kur dredhon, duhet së pari që të fillosh të presësh materialin, dhe pastaj ta shtypni në vendin e shënuar.
- Punimet nga letra dhe gjysmë kartoni bashkoi me: ngjitës, gjilpërë dhe pe.
- Punimet e gatshme ngjyrosi dhe zbukuroi sipas dëshirës tënde.



### Nëse kështu mendon do të mësosh

- Të bësh sende nga letra dhe gjysmë kartoni, do t'i përvetësosh procedurat e punës dhe shumë lehtë do të fitosh prodhim të gatshëm.
- Me kujdes përdori mjetet dhe veglat.
- Keni kujdes të mos lëndoheni.
- Pas punës, vendin e punës çdoherë ta lini të pastruar.



Prodhim i gatshëm nga letra dhe kartoni



### HULUMTO DHE KUPTO

- Në çka kanë shkruar njerëzit para zbulimit të letrës?
- Gjurmo pas informatave, dhe zbulo si quhen fabrikat për prodhimin e kartonit?
- Çka paraqet riciklimi i letrës së vjetër, a ka prodhues në vendin tënd?
- Pse letra duhet të ruhet në hapësira të thata?



## PËRPUNIMI I ORIGAMIT

Origami është shkathtësi tradicionale japoneze për bërjen e figurave nga letra. Letra ekziston në lloje të ndryshme ngjyrash ose dizajne japoneze. Vetë letra është shpikur në Kinë. Si art japonez aplikohet në modelimin e letrës. Krijimi i saj daton që prej para dhjetë shekujve.


Shkathtësia e bërjes së origamive është përcjellë nga gjenerata në gjeneratë. Në këtë kënaqen fëmijët dhe të rriturit. Ajo është shkathtësi argëtuese dhe edukative e cila mund të na dhurojë orë të pafundme të argëtimit. Kjo shkathtësi e përmirëson koncentrimin dhe motoriken e duarve. Gjithçka që është e nevojshme, është një copë letër.

Në librin dhe fletoren e punës do të keni mundësi që të mësoni se si të bëni figura nga më e thjeshta deri te më e komplikuar. Origamitë (figurat) tuaja mund të përdoren për argëtim, dekorim të dhuratave, zbukurimet e Vitit të Ri etj.

### VËZHGO DHE SQARO



- Në fotografi janë dhënë shembuj të origamive.
- Në orët e arsimit teknik do të kesh mundësi që në mënyrë praktike të bësh detyra pune dhe origami: kartolina, shenja komunikacioni, katrorë, zarfe, lule dhe shumë gjëra të tjera.




### HULUMTO DHE KUPTO

- Me ndihmën e arsimtarit gjeni të dhënat se sa kjo shkathtësi e përpunimit të origamive është e përfaqësuar te ne.



1




2

1





2







## HULUMTO DHE KUPTO

- Mundeni të krijoni ide personale për origamitë. Vetëm fantazma juaj i vendos kufijtë për përdorimin e figurës së mbaruar origamie.
- Sipas fotografive të dhëna konstrukto figura nga gjysmë kartoni.



Rrjeti i katrorit




Rrjeti i kuadrit




*Nëse kështu mendon, do të mësosh:*


- Të bësh rrjet të figurave vijuese gjeometrike



Cilindri



Piramida



Koni

## PËRFTIMI I TEKSTILIT

Tekstili është material i cili përdoret në jetën e përditshme. Tekstili përftohet me përpunimin e pambukut, mëndafshit, lirit, leshit, dhe fijeve sintetike. Sipas llojit të lëndës së parë nga i cili përpunohet tekstili dallojmë (pambuk, lir dhe konop) natyral dhe artificial (sintetik). Tekstili prodhohet në më shumë mënyra, por më së shpeshti me endje.



Pëlhura



Tezgjahu

## VËZHGO DHE SQARO

- Ç'është treguar në fotografi?
- Si bëhet endja?
- Shpjego pse njerëzit më parë e kanë përdorur tezgjahun?
- A ke pasur mundësi të shohësh prodhim të endur në tezgjah?




Endja



## HULUMTO DHE KUPTO

- Tekstili si material teknik lehtë përpunohet. Pse?
- Puna me tekstil është e shumëllojshme, mund të bësh kreacione të llojlojshme.
- A e ke të njohur profesionin e tillë?



Punime dore nga tekstili dhe peri

## VËZHGO DHE SQARO



- Bëni koleksion prej materialesh të ndryshme tekstili dhe hapni diskutim.
- Shqyrto idetë e ofruara të punuara prej tekstili dhe sipas idesë tënde bëni tuajën.
- Para se t'i punoni modelet nga tekstili i modelon sipas dimensioneve, pastaj i bashkon me qepje në dorë ose me makinë.



Prodhimet e gatshme nga tekstili



## ZBULO PSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Në mënyrë ekipore hulumtoni veçoritë e tekstilit: **absorbimin e ujit, elasticitetin dhe butësinë**, dhe rezultatet e fituara shënoni në një fletore pune.



## NJOHJA ME GJYSMË-PRODHIMET E DRURIT

Druri është pjesë e natyrës së gjallë që na rrethon. Ajo ekziston shumë vite para krijimit të njeriut. Pa drurin shumë vështirë është të pramendohet jetë normale dhe e shëndetshme. Pyjet janë pasuria natyrore e njeriut. Ajrin e begatojnë me oksigjen, ndërsa ndikojnë edhe në përmirësimin e kushteve klimatike. Kapin hapësirë prej një të katërtën e hapësirës së Tokës. Mjedisin jetësor e bëjnë të volitshëm për jetë për të gjitha gjallesat dhe për njeriun.

Bashkë me zhvillimin, është rritur edhe përdorimi i drurit në jetën e përditshme të njeriut. Nga ndërtimi i shtëpive moderne për të jetuar, përpunimi i mjeteve për udhëtim, urave, binarëve të hekurudhës, enterierit, deri te mjeti elementar për komunikim me shkrim -letra



Pylli



Ndërtim druri

Sot, druri përdorimin e tij më së shumti e gjen në industrinë bashkëkohore ndërtimore dhe në atë të përpunimit të drurit. Mund të gjendet të forma më të ndryshme dhe ngjyra në çdo shtëpi, hapësirë veprimtarie, shkolla, edhe atë në formë të trarëve, binarëve, dërrasave, dhe gjysmë-prodhimeve të tjera si dhe dyer, dritare, tavolina, karrige, banka, shkallë, mobile etj.



Prodhimet e gatshme prej druri





Druri prehet dhe i hiqen degët. Trungu, me ndihmën e sharrave prehet në gjatësi të caktuar dhe fitohen trupa - **druri teknik**. Trupat transportohen deri te sharrat, ndërsa makinat me të cilat bëhet prerja quhen **gaterë**.



Rruga e drurit nga pylli  
deri te fitimi i prodhimit të  
gatshëm




## HULUMTO DHE KUPTO

- Mundohu që të kuptosh çfarë lloje të drurit gjenden në rrethin tënd.
- Në mënyrë të organizuar vizitoni industrinë e përpunimit të drurit që të njiheni me procesin e fitimit të prodhimeve të gatshme nga druri.

## VËZHGO DHE SQARO


- Në fotografi është treguar prerja horizontale e trungut.
- Përcakto pjesët: *lëvorja, masa e drurit, dhe zemra*

Unazat prej mesit të trungut drejt lëvores quhen unazat e viteve. Në çdo unazë të drurit dallohen dy pjesë. Pjesa më afër qendrës është më e ndritshme sipas ngjyrës dhe është e ndërtuar prej elementeve të gjëra. Kjo pjesë formohet në pranverën e hershme kur rritja e drurit është më intensive dhe quhet druri i hershëm ose druri i pranverës. Pjesa e jashtme nga unaza quhet druri i verës sepse formohet në verë. Zemra e drurit - druri i vdekur është ngjyrosur me ngjyrë të mbyllur, ndërsa druri i gjallë aktiv është unazë e ndritshme.



Në fotografi ka 27 unaza.

Cakto sa vite ka druri?





### **Përftimi i gjysmë-prodhimeve nga druri**



**Furniri** fitohet më së shumti nga drurët gjetherënës edhe atë në dy mënyra. Me qërimin rrethor dhe vertikal të trungjeve

**Kompensanta** fitohet me ngjitjen e kryqëzuar të më shumë fletëve të furnirit. Fletët bashkohen me ngjitës në kënd të drejtë.



**Panel-pllaka** përftohet nga druri i butë. Fitohet nga qeprat e hollë, të renditura dhe ngjitura njëra me tjetrën, dhe të mbuluara e të ngjitura me fleta furniri.

**Lesonit-pllaka** përftohet nga byku i sharrës, i cili futet në kazanë speciale, përzihet me ngjitës dhe zihet në avull. Masa e fituar presohet në makina speciale - presa.



**Pllakat** e ashklave përftohet prej ashklave të gdhendura të drurit të përziëra me ngjitës dhe të presuara.

- Trarët
  - Qeprat
  - Dërrasat
-  Gjysmë-prodhime



*Nëse kështu mendon, do të mësosh*

- Prodhimet e drurit fitohen në industrinë e përpunimit të drurit dhe mbarojnë në shtëpitë tuaja si prodhime të gatshme.




Prodhimet e gatshme të përpunuara nga druri



## MBROJTJA E DRURIT

Kualiteti dhe veçoritë e drurit varen nga: rritja e drurit, renditjes së qelizave, lidhshmërisë së tyre dhe dendësisë, si dhe nga sasia dhe kualiteti i lëngjeve që i përmban vetë druri.

Druri teknik duhet patjetër të mbrohet nga lagështia sepse është i ndjeshëm. Gjatë trajtimit teknik druri duhet të jetë i thatë, sepse më lehtë përpunohet. Druri i thatë është izolator i mirë i nxehtësisë dhe rrymës elektrike, ka pamje të bukur dhe ka fortësi të madhe.



Mbrojtja e drurit me lyerje



## ZBULO PSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Sendet prej druri mbrohen nga goditjet e jashtme, nga lagështia ndërsa prej brenda nga organizmat e gjallë - insektet. Çka do të ndodhë nëse druri nuk është i mbrojtur? Ku është dallimi?
- Mësoji mjetet mbrojtëse të cilat përdoren te druri, që ta vazhdojmë qëndrueshmërinë e tij.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Me mbjelljen e fidanëve të rinj, do të kontribuojmë për mjedis më të shëndoshë dhe më të pastër.
- Sjellja e pandërgjegjshme e njeriut, shkakton ndryshime të llojllojshme. Rritja e temperaturës në nivel global dhe shkaktimi i vërshimeve dhe erozioneve të tokës.
- Në botë çdo ditë zhduken një numër i madh pyjesh, ekzistimi i të cilave është i domosdoshëm, sepse ato janë mushkëritë e planetit tonë.
- Është e nevojshme që të punohet në mënyrë intensive në ngritjen e vetëdijes së njeriut, në kuptim të kujdesit më të mirë për natyrën.




## PROCEDURAT E PUNËS GJATË PËRPUNIMIT TË DRURIT




Druri përpunohet me dorë dhe me makinë. Përpunimi makinerik i drurit më shpesh përdoret në industrinë e përpunimit të drurit. Për kryerjen e detyrave të punës nga gjysmë-prodhimet prej druri duhet të bëhen disa hapa. Për fitimin e prodhimit të gatshëm këta hapa paraqesin procedurë pune.


**Shënimi** është bartja e dimensioneve të drurit me laps.



**Prerja** është operacion i cili paraqet ndarje të një pjese të materialit të drurit. Vegla me të cilën kryhet ky operacion është sharra.



**Rrafshimi** është operacion mbi drurin i cili kryhet për pamje më të mirë estetike të sendit që e përpunon.




**Limimi** është operacion i cili përdoret gjatë punimeve përfundimtare të drurit. Kryhet me lloje të ndryshme të limave.

**Shpimi** është procedurë që përdoret për hapjen e vrimave në dru. Kjo bëhet me turjelë.



**Thellimi-skalitja** është operacion i cili bëhet me daltë, dhe në dru mund të krijohen figura të ndryshme.



**Bashkimi** është operacion me ngjitje, ndërsa shërben për bashkimin e pjesëve të punuara të sendit nga druri.

*Çdo i ri ka për detyrë që në oborrin shkollor të mbjellë të paktën një dru, ta kultivojë dhe të rritet bashkë me të.*



## KRIJIMTARIA KONSTRUKTIVE



Krijimtaria konstruktive është veprimtari teknike e cila merret me projektimin dhe konstruktimin e llojeve të ndryshme të: makinave, aeroplanëve, raketave, urave, automjeteve etj.



Konstruksionet



Njeriu, para se të fillojë që të punojë, përgatitet, mendon, punon skica, dhe vizatime teknike. Që të jesh i suksesshëm çdoherë planifiko se çka do të punosh. Njeriu i shfrytëzon pasuritë natyrore, respektivisht gjysmë-prodhimet dhe nga ato krijon gjithçka që ka nevojë.

Rruga nga gjysmë-prodhimet deri te të mirat materiale është proces i ndërlikuar. Aplikimi i ligjeve natyrore të zbuluara gjatë shekujve në masë të madhe ia lehtësojnë punën njeriut.



Arkimedi

“Më jepni një lloz që është mjaftueshëm i gjatë dhe një pikë mbështetëse në të cilën mund ta vendosi llozin dhe do ta zhvendosi botën – planetin e Tokës”





## ELEMENTET PËR MBËRTHIM (VIDHA DHE KUNDËRVIDHA)




Materiali konstruktiv më shpesh është i punuar nga metali, masa plastike ose druri. Këto materiale janë të vendosura në kuti speciale në të cilat ka elemente makinerike dhe udhëzim për punë.



### Nëse kështu mendon, do të mësosh

- Mbërthimi i pjesëve gjatë ndërtimit të modeleve më shpesh realizohet me vidha dhe kundërvidha.
- Vegla elementare e dorës për punë është kaçavida dhe çelësi.



Vegla dore



Vidha dhe kundërvidha

- Vidha shtrëngohet në drejtim të akrepave të orës, ndërsa lirohet në drejtim të kundërt.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Vidhat dhe kundërvidhat mos i shtrëngo deri në fund. Atë do ta bësh kur do t'i bashkosh të gjitha elementet e modelit tënd.
- Ndarjen e elementeve bëje me renditje të kundërt nga mbërthimi.

***Vëzhgo, hulumto, ndërto dhe argëtohu***



## ***MONTIMI DHE DEMONTIMI I MODELEVE DHE MAKETEVE NGA ELEMENTET E GATSHME***

Materiali konstruktiv të jep mundësi që të ndërtohet makete dhe modele të llojllojshme. Mundohet që sipas idesë personale të konstruktosh model tëndin.



Materia konstruktive –  
module nga plastika

## **VËZHGO DHE SQARO**



- Çka duhet të bësh para se të fillosh me punë?
- Zgjidh model ose maket të cilin do ta ndërtosh.
- Mësoje udhëzimin për punë.
- Ndaji elementet e nevojshme për montim, respektivisht ndërtim.
- Bashkoi pjesët sipas renditjes që të është dhënë në udhëzim.



## ZBULO PSE ËSHTË E RËNDËSISHME

- Konstruksionet origjinale janë gjithkund përreth nesh.
- Shoqërohu me teknikën, ajo është kënaqësi e vërtetë.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Do të kesh mundësi të konstruktosh modele nga sende të ndryshme dhe makina të thjeshta sipas idesë individuale. Ndërtimi i modeleve presim që të nxisë interes për krijimtari te çdo nxënës.
- Nëse i përvetëson procedurat elementare në punë nuk do të kesh vështirësi gjatë konstruktimit.
- Përgatitu që të bëhesh konstruktor.




Konstruksionet



## APLIKIMI PRAKTIK I ORIGJINALEVE

Është e njohur dëshira e njeriut që gjatë realizimit të ndonjë pune ta zvogëlojë pjesëmarrjen e vetë me aplikimin e aparateve dhe pajisjeve të caktuara. Njeriu mendon, ka një mori idesh, krijon, konstrukton, me të vetmin qëllim që ta lehtësojë punën, e bashkë me këtë të arrijë edhe rezultate me të mëdha në punë. Llozi dhe makaraja shumë shpesh gjejnë aplikim në praktikën e origjinaleve.

Forca është munda i nevojshëm për ngritje



Shumë më lehtë është që të ngrihet në lartësi peshë e madhe nëse përdorim tra të cilin e quajmë **lloz**. Llozin e mbështesim në mbështetës. Duhet patjetër ta shtypim më shumë se sa duhet që ta ngremë peshën.



## HULUMTO DHE KUPTO

- Në fotografi është treguar karrocë për bartjen e peshës.
- Zbulo ç'është llozi, ç'është mbështetësi te karroca?
- Gërshërët gjithashtu paraqesin llozin. Zbulo cili vend i gërshërëve paraqet mbështetëse?





## HULUMTO DHE KUPTO

- Aplikimi i konstruksioneve në praktikë?
- Sipas konstruksioneve origjinale ti punon modele. Të njëjtat kanë rëndësi të veçantë në jetën dhe punën e njeriut.
- Bëni krahasimin e origjinaleve të paraqitura dhe modeleve të tyre.
- Sigurisht keni ide. Bëni model sipas origjinalit të parë dhe të paramenduar.



Mbrohu gjatë punës



Ekskavatori është makinë e cila përdoret për gërryerjen e tokës. A ke parë në natyrë ekskavator?



Kamioni është makinë i cili shërben për bartjen e ngarkesës.



Në fotografi është paraqitur konstruksioni metalik i urës. Nga cili material ndërtohen modelet të ngjashme me origjinalet?



## KOMUNIKACIONI



Njohuritë e përparshme për komunikacion do të ndihmojnë që ta realizosh dhe ta zgjerosh këtë përmbajtje mësimore.

Nevoja për udhëtimin e njerëzve deri te vendet e tyre të punës, bartja (transporti) i prodhimeve dhe informatave prej një vendi në tjetrin vend të punës, imponojnë zhvillim të shpejtë dhe të sigurt të komunikacionit. Zhvillimi i sistemeve të komunikacionit dhe ngritja e kulturës së komunikacionit dhe sjellja e pjesëmarrësve në komunikacion është nevojë e përditshme



*Udhëkryq i rregulluar*



*Udhëkryq i pa rregulluar*

Ngritja e kulturës së komunikacionit nënkupton sjellje të disiplinuar dhe komunikim të ndërsjellë të pjesëmarrësve në komunikacion. Ekzistojnë tri lloje të komunikacionit: tokësor, ujor dhe komunikacion ajror.

Kodi domethënës formë, simbol, shenjë me marrëveshje ose numra me të cilat zëvendësohet një simbol grafik me tjetër. Kodet mund të jenë shkronja, numra, sinjale të dritës ose të zërit me rëndësinë e caktuar prej më parë, shenja të komunikacionit etj.

### Shenjat e komunikacionit



Rrugë me përparësi kalimi



Ndalim i obliguar




Kryqëzimi i rrugës me përparësi kalimi




**Rrugë** komunikacioni është pjesë e sipërfaqes së rrugës, e destinuar për komunikacion të automjeteve. Elementet e rrugës janë: *shiriti i rrugës, shiriti i korsisë, shtegu për çiklistë, sipërfaqja e gjelbër dhe trotuari.*

Këmbësori sipas rregullit, nuk duhet të lëvizë dhe të ndalet në rrugën për komunikacion. Në rrugët, të cilat ka trotuar dhe sipërfaqe tjetër të përshtatshme për lëvizje, këmbësorët janë të obliguar të lëvizin nëpër ato sipërfaqe.


Këmbësorët kur lëvizin nëpër rrugë, për shkak të sigurisë së tyre duhet të lëvizin më afër skajit të rrugës nga ana e djathtë njëri pas tjetrit. Kur këmbësori lëviz në rrugë publike, jashtë vendbanimit, është i obliguar që të lëvizë sa më afër skajit të majtë të rrugës automobilistike, në drejtimin e lëvizjes, ashtu është më i sigurt.



Këmbësori nuk guxon që ta kalojë rrugën jashtë nga vendkalimi i këmbësorëve përveç se kur vendkalimi është më larg se 100 metra, por nuk duhet që ta pengoj lëvizjen e veturave. Në udhëkryq, i cili është i rregulluar me shenja drite të komunikacionit për këmbësorë, këmbësori është i obliguar që t'i respektojë të njëjtat.



Në vendkalim, sipas rregullit, këmbësori lëviz nga ana e djathtë. Në trotuar nuk është e lejuar luajtje dhe pengim nëse me atë pengohet lëvizja e këmbësorëve dhe njerëzve tjerë të cilët janë të kyçur në komunikacion.



***Me kujdes, vëmendshëm, sigurt***



## RREGULLA DHE DISPOZITA PËR LËVIZJEN E KËMBËSORËVE NË KOMUNIKACION

Që të jesh i sigurt në komunikacion duhet t'i mësosh dhe respektosh rregullat dhe dispozitat e komunikacionit. Ti je pjesëmarrës në komunikacion. Në rrugët vëren shenjat e komunikacionit, vijat e bardha të vizatuara, shigjeta, semaforë, vija të ndërprera dhe të plota etj. Vëren shumë automjete dhe mjete të komunikacionit të cilat lëvizin në komunikacion.

Si pjesëmarrës në komunikacion duhet të dish që rrugën ta kalosh në vendkalim.

- **Vendkalimi** është sipërfaqe e rrugës e caktuar për kalimin e këmbësorëve që është shënuar me ngjyrë të bardhë ose me shenjë adekuate të komunikacionit.

Kur e kaloni rrugën më sigurt është. Që atë ta bëni në **vendkalim** për **këmbësor**.



- **Trotuari** është sipërfaqe e caktuar për lëvizjen e këmbësorëve. Këmbësori lëviz nga ana e djathtë e trotuarit. Në rrugët ku nuk është ndërtuar trotuar, këmbësorët lëvizin nga ana e majtë e rrugës.

Çdo herë lëvizni nëpër shtegun e këmbësorëve - **trotuari**. Ju jeni të sigurt.








## RREGULLIMI I KOMUNIKACIONIT NË UDHËKRYQ ME SHENJAT E KOMUNIKACIONIT DHE ME SINJALIZIM DRITE

- Nëse nuk ka të ndërtuar shteg të posaçëm për këmbësorë, lëvizni përgjatë skajit të rrugës për automjete me kujdes dhe vëmendje të zmadhuar.
- Kur lëvizni në grup, çdoherë lëvizni njëri pas tjetrit, ashtu është më sigurt.
- Rrugën kaloni në *vendkalimin për këmbësorë*, të jeni mjaft të kujdesshëm dhe vëmendshëm.

Në udhëkryqin e rregulluar, komunikacioni rregullohet në tri mënyra:

- Semafor të komunikacionit
- Polic të komunikacionit
- Shenjë të komunikacionit




Në udhëkryqin e parregulluar Përparësi kalimi kanë veturat që vijnë nga ana e djathtë.



Çka të paralajmëron sinjalizimi vertikal në rrugë? Siguria jote në komunikacionin rrugor, varet nga sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugës. Për çfarë sinjalizimi bëhet fjalë në fotografi?



Vëzhgo dhe sqaro. Definoji shenjat e komunikacionit. Nëse në afërsi të shkollës tënde Ke vërejtur shenja të komunikacionit si në fotografi, hap diskutim dhe sqaroi ato.



Sinjalizimi horizontal i vizatuar në rrugë.

Në çka të paralajmërojnë shenjat e komunikacionit? Definoji ato.



Sinjalizimi vertikal



## HULUMTO DHE KUPTO

- Shenjat e komunikacionit, përveç se na informojnë për rregullat në komunikacion ato edhe na paralajmërojnë.
- Për çfarë sinjalizimi bëhet fjalë në fotografinë e sipërtreguar?
- Çka nënkupton me kulturën e komunikacionit?
- Nëse nuk i mëson dhe aplikon rregullat dhe dispozitat në komunikacion çka do të ndodh?

## VËZHGO DHE SQARO



- Kur del nga shkolla ku dhe si duhet ta kalosh rrugën?
- Me çka është rregulluar komunikacioni në rrethin tënd më të afërt?

***Kultura e komunikacionit paraqet dituri, njohje dhe aplikim i rregullave dhe dispozitave të komunikacionit***



## VIZATIMI I SHENJAVE TË KOMUNIKACIONIT NË *P*AINT

Në kabinetin e informatikës, vizatoji në *Paint* shenjat e komunikacionit. Shenjat e komunikacionit janë të ndara në:

- Shenja për rrezik



- Shenja për urdhra të prerë:

- Shenja për ndalim



- Shenja për obligim



- Shenja për lajmërim



## HULUMTO DHE KUPTO

- Zgjeroje diturinë tënde. Vizato edhe shenja tjera të cilat të rrethojnë ose i ke parë në rrugë.



## NOCIONE TË PANJOHURA - FJALOR

- **Ambalazh** – të gjitha materialet që shërbejnë për paketim, mbështjellje.
- **Celulozë** – aplikohet në prodhimtari për fitimin e letrës.
- **Erozion** – ndarje, shembje e sipërfaqes së tokës.
- **Ide** – mendim i cili papritmas të bie në mend.
- **Ilustrim** – përshkrim, pasqyrim.
- **Instrument** – mjet pune për qëllime shkencore, teknike.
- **Klasifikim** – renditje në grupe, sistemim.
- **Kod** – shifër, çelës.
- **Komunikim grafik** – të folurit me shkrim, bisedë përmes skicës dhe vizatimit teknik.
- **Konstrukton** – formon, organizon, bashkon.
- **Konstruktor** – personi i cili ndërton.
- **Krijim** – krijon diçka të re, origjinale, zbulon, përpunon, gjen.
- **Materiale** – sende të cilat na rrethojnë.
- **Patentë** – zbulim i ri, shpikje e re.
- **Presim** – shtypje.
- **Mbështjellje** – veshje, mbështjell me letër.
- **Realizim** – realizon, zbaton diçka.
- **Riciklim** – përdorimi i sërishëm i materialit.
- **Sintetike** – bashkimi përmes rrugës artificiale.
- **Sistem** – përmbledhje.
- **Specifikim** – rregullim.